




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
OSNOVNI SUD UROŠEVAC – BASIC COURT OF FERIZAJ



Raporti i rregullt i punës
GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
Korrik-Shtator 2023

RAPORTI I RREGULLT I PUNËS SË GJYKATËS THEMELORE NË FERIZAJ
(Periudha 1 korrik deri me 30 Shtator 2022)

Bazuar në nenin 14 paragrafi 2 pika 2.5 të Ligjit për Gjykatat, Kryetari i Gjykatës Themelore në Ferizaj, paraqet raportin e rregullt të punës për periudhën 1 korrik - 30 shtator 2023.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë në dhjetor të vitit 2022 ka hartuar planin dhe programin e punës për vitin 2023, plan ky i aprovuar në kolegjiunin e gjyqtarëve të Gjykatës Themelore dhe degëve të sajë, në kuadër të këtij plani është paraparë trajtimi në mënyrë specifike i efikasitetit të gjykatës në kuptimin e veprimeve të cilat ndërlidhen me zgjidhjen e numrit të lëndëve gjegjësisht çështjeve gjyqësore brenda afateve të arsyeshme ligjore, gjë që konsiderojmë se në tremujorin e parë dhe të dytë të vitit 2023 ky plan është zbatuar.

Gjykata Themelore në Ferizaj së bashku me degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë përmes këtij raporti prezanton në mënyrë përmbledhëse punën e gjykatës gjatë tremujorit të tretë të vitit 2023, duke prezantuar njëkohësisht të arriturat dhe sfidat gjatë kësaj periudhe raportuese, si në aspektin profesional ashtu edhe në atë administrativ, me qëllim të paraqitjes së volumit të punës së kryer në formë statistikore dhe tabelore në vazhdim.

Aktualisht Gjykata Themelore në Ferizaj me degët në Kaçanik dhe Shtërpcë ka të angazhuar gjithsejtë njëzet e tetë (28) gjyqtar, duke përfshirë edhe kryetarin e gjykatës. Ndërsa numri total i të punësuarve në Administratën e Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpcë është 131 persona përfshirë Administratorin e gjykatës dhe dy ndihmës administrator.

Në aspektin financiar, gjatë periudhës raportuese, ekipi financiar ka qenë i konsoliduar dhe ka arritur ti përfundoj me sukses detyrat që kanë të bëjnë me çështjet financiare. Në këtë periudhë raportuese (korrik-shtator 2023), zyra e financave ka realizuar: të hyra gjyqësore të cilat janë derdhur në

Buxhetin e Konsoliduar të Republikës së Kosovës e që kanë qenë 223,700.00 €, prej tyre 178,160.00 € janë të hyra nga gjrobat dhe 769,007.58 € pagesa nga taksat dhe paushallët gjyqësore, ndërsa shpenzime buxhetore për nevojat e gjykatës gjatë këtij tremujori kanë qenë 56,941.53 €, prej tyre 44,543.58 € janë shpenzuar për mallra dhe shërbime, ndërsa 12,397.95 € për shpenzime komunale.

Gjykata për periudhën raportuese, në kuadër të Udhëzimit Administrativ (02/2016) për Anonimizimin dhe Publikimin e Aktgjykimeve, ka vazhduar publikimin e aktgjykimeve të anonimizuara dhe për këtë periudhë janë publikuar rreth 591 aktgjykime.

Web Portali i gjyqësorit edhe për këtë periudhë ka shërbyer si urë lidhëse ndërmjet publikut dhe gjykatës kjo me qëllim të informimit të publikut rreth aktiviteteve, orarit të seancave gjyqësore, vendimeve dhe të tjera, ndërsa përmes rrjetit social facebook publikut i është mundësuar qasje më e lehtë në punën e gjykatës. Përveç këtyre shërbimeve të cilat ofrohen në portalin gjyqësor dhe rrjetet sociale, si shërbime shtesë të cilat dëshmojnë transparencën e gjyqësorit karshi publikut, në hyrje të gjykatës janë të vendosur tre monitorë të cilët pasqyrojnë kalendarin me orarin e seancave gjyqësore si dhe tabela orientuese, këto si në Gjykatën Themelore në Ferizaj ashtu edhe në degët e sajë në Kaçanik dhe Shtërpçë.

Gjithashtu Gjykata Themelore Ferizaj e përkrahur nga USAID- Projekti për Drejtësi është duke vazhduar Projektin për Drejtësi Procedurale që ka për qëllim përmirësimin e cilësisë dhe qasje në shërbimet të cilat ofrohen nga gjykata.

Ndërsa në po këtë tre mujor në Gjykatën Themelore në Ferizaj, në sallat e gjykimeve, ka filluar montimi i pajisjeve për ingjizimin e seancave gjyqësore -audio-ingjizimi, projekt ky i financuar nga Ambasada Amerikane, e cila parashihet edhe me kodin e ri të Procedurës Penale.

Gjykata Themelore në Ferizaj gjatë kësaj periudhe ka vazhduar bashkëpunimin me institucione, veprimtaria e të cilave mundë të ketë ndikim në aspektin e efikasitetit apo të ngritjes së besueshmërisë së opinionin publik përgjithësi në gjykatë ka vazhduar të shfaqë efekte pozitive si në zbatimin e urdhërësive të lëshuara nga gjykata, ashtu edhe me zbatimin e vendimeve nga ana e institucioneve si nga ana e Policisë së Kosovës ashtu edhe Prokurorisë Themelore në Ferizaj.

Bashkëpunimi me Prokurorinë Themelore në Ferizaj është i vazhdueshëm, po aq sa edhe me Policinë Rajonale të Ferizajt.

Po ashtu gjatë periudhës raportuese sipas vendimit të KGJK-së, nga data 1 shkurt e sipas udhëzimeve të zyrtarëve të departamentit të IT-së në SKGJK, gjykata ka filluar me procedimin e ankesave në lëmin penale gjatë procedurës paraprake në mes të gjykatave Themelore dhe Gjykatës së Apelit përmes Sistemit për Menaxhimin Informativ të Lëndëve (SMIL) dhe procedimin e ankesave përmes SMIL-it në Gjykatën e Apelit, gjë e cila ka vazhduar me sukses edhe gjatë tremujorit të tretë.

Statistikat

Gjatë periudhës raportuese gjykata ka të evidentuara në punë 22503 lëndë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) në Departamentin për Krime të Rënda, në Departamentin e Përgjithshëm, Divizioni Penal dhe Civil, janë përfunduar 1507 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 20996 lëndë.

Departamenti për Krime të Rënda gjatë periudhës raportuese ka pranuar 24 lëndë, ka përfunduar 29 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 266 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë në DKR është 120.83%.

Departamenti për të Mitur në periudhën raportuese ka pranuar 27 lëndë, ka përfunduar 33 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 161 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 122.22 %.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal (së bashku me degë), pa përfshirë procedurën paraprake në periudhën raportuese ka pranuar gjithsej 302 lëndë, ka përfunduar gjithsej 305 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 3103 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 100.99%.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil (së bashku me degë), gjatë këtij tremujori janë pranuar gjithsej 1029 lëndë, ka përfunduar 493 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 9333. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 47.91 %. Kjo përqindje e ulët e normës së spastrimit është si rezultat i ardhjes së numrit të madhe të kërkesave civile, konkretisht lëndëve

që kanë të bëjnë me kontratat kolektive të punonjësve të arsimit, shëndetësisë dhe policisë. Po ashtu nga ky divizion një gjyqtar ka qenë në pushime mjekësore.

Në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Kundërvajtës (së bashku me degë) gjatë këtij tremujori ka pranuar gjithsej 863 lëndë, ka përfunduar 720 lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa përfunduara 4864 lëndë. Norma e spastrimit të lëndëve për këtë periudhë është 83.43 %.

Gjykata Themelore në Ferizaj me Degë

Në vazhdim tabela 1 përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e dytë të vitit 2023 (-1 korrik deri më 30 shtator 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj me degë



Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	617	63	680	45	635
Penale shkalla e parë- DP	3106	302	3408	305	3103
Procedurë Paraprake - DKR	243	38	281	34	247
Penale shkalla e parë - DKR	271	24	295	29	266
Penale për të mitur në proc.përgaditore	46	6	52	5	47
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	167	27	194	33	161
Civile të shkallës së I-rë	8797	1029	9826	493	9333
Jashtëkontestimore	607	96	703	108	595
Përmbarmore	4392	565	4957	212	4745
Përbarime sipas dokumenteve autentike	1908	0	1908	55	1853
Përbarime sipas dokumentit përbarues	743	98	841	118	723
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	4342	473	4815	297	4518
Ekz.civile PPP	382	90	472	62	410
Ekz.Penale me burg	184	29	213	46	167
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	1014	168	1182	180	1002
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJTI	26819	3008	29827	2022	27805
Lëndët tjera: certifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0

Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	4721	863	5584	720	4864
GJITHËSEJTI	4721	863	5584	720	4864

Në bazë të statistikave si në tabelën më lartë rezulton se Departamenti për Krime të Rënda, shprehur në përqindje ka përfunduar 120.83 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, shprehur në përqindje ka përfunduar 126.84 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në periudhën raportuese, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, shprehur në përqindje ka përfunduar 47.91 % të lëndëve në raport me numrin e lëndëve të pranuar në periudhën raportuese.

Ndërsa në total norma e spastrimit të lëndëve të pranuar në raport me lëndët e përfunduara në Gjykatën Themelore në Ferizaj së bashku me degët Kaçanik dhe Shtërpcë (pa përfshirë lëndët kundërvajtëse) është 62.23 %, megjithatë kjo shkallë e efikasitetit duhet të ngritet, andaj gjatë


muajve në vijim prioritet i gjykatës do të vazhdoj të jetë përfundimi i sa më shumë lëndëve të vjetra të parapara edhe me strategjinë për reduktimin e lëndëve të vjetra si dhe përfundimi i lëndëve me natyrë korruptive.

Gjykata Themelore në Ferizaj

Për periudhën raportuese nga data 1 korrik deri me 30 shtator 2023 në Gjykatën Themelore në Ferizaj lëndë të pranuar në punë kanë qenë 2170 lëndë, prej tyre 618 janë nga lëmia kundërvajtëse. Lëndë të kryera në këtë periudhë janë 1507 lëndë, prej tyre të divizionit për kundërvajtje janë kryer 501 lëndë.

Për tremujorin e tretë të këtij viti lëndë të raportuara si të pa kryera janë gjithsej 20996 lëndë, nga ky numër 3793 janë lëndë të divizionit për kundërvajtje.

Në vazhdim tabela përmban të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e tretë të vitit 2023 (1 korrik deri më 30 shtator 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj



Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuarra-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	465	42	507	22	485
Penale shkalla e parë- DP	2142	212	2354	205	2149
Procedurë Paraprake - DKR	243	38	281	34	247
Penale shkalla e parë - DKR	271	24	295	29	266
Penale për të mitur në proc.përgaditore	46	6	52	5	47
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	167	27	194	33	161
Civile të shkallës së I-rë	7030	739	7769	394	7375
Jashtë kontestimore	275	83	358	71	287
Përmbarime	3129	410	3539	182	3357
Përmbarime sipas dokumenteve autentike	1283	0	1283	54	1229
Përmbarime sipas dokumentit përmbarues	679	98	777	118	659
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	3394	285	3679	144	3535
Ekz.civile PPP	229	63	292	38	254
Ekz.Penale me burg	149	24	173	40	133
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	831	119	950	138	812
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJTI	20333	2170	22503	1507	20996
Lëndët tjera: certifikata, vapistile, etj	0	0	0	0	0

Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuarra-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	3676	618	4294	501	3793
GJITHËSEJTI	3676	618	4294	501	3793


Gjatë tremujorit të tretë, angazhimi i gjyqtarëve me qëllim të zvogëlimit të numrit të lëndëve dhe zgjedhjes sa më shpejtë të tyre ka reflektuar pozitivisht, megjithatë duhet të theksohet fakti se Gjykata Themelore në Ferizaj vazhdon të ketë mungesë të numrit të gjyqtarëve në të gjitha departamentet. Aktualisht në Departamentin për Krime të Rënda janë të angazhuar pesë (5) gjyqtar përfshirë edhe kryetarin e gjykatës, në Departamentin për të Mitur është i angazhuar një (1) gjyqtar, në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Penal janë të angazhuar katër (4) gjyqtar (një gjyqtare në këtë divizion është në pushim lehonie, në Departamentin e Përgjithshëm-Divizioni Civil janë të angazhuar shtatë (7) gjyqtar (dy prej të cilave janë të minoritetit serbë dhe kanë vështirësi në kryerjen e punëve në gjykatë, për shkak të nevojës së përkthimit të dokumentacionit, mungesës së zyrtarëve ligjor dhe stafit mbështetës serbë), përfshirë këtu edhe gjyqtarin mbikëqyrës të degës në

Shtërpcë i cili trajton vetëm lëndët me të cilat ka qenë i ngarkuar më parë, ndërsa një gjyqtar në këtë divizion është i ngarkuar për trajtimin vetëm të lëndëve përmbare.

Vlen për ta përmendur se një gjyqtare e divizionit penal nga data 19.06.2023 është në pushim të lehonisë. Ndërsa në Divizionin për Kundërvajtje janë të angazhuar dy (2) gjyqtar. Në Gjykatën Themelore në Ferizaj- dega në Kaçanik aktualisht janë të angazhuar 4 gjyqtar duke përfshirë edhe mbikëqyrësin e degës, ndërsa në Gjykatën Themelore në Ferizaj – dega në Shtërpcë janë të angazhuar mbikëqyrësi i degës me lëndë të natyrës civile, dhe një gjyqtar në lëmine penale dhe kundërvajtëse, pasi që tani më nga muaji gusht i këtij viti një gjyqtarë i Degës së Shtërpcës i cili ka qenë i ngarkuar me lëndët të lëmisë Civile dhe kundërvajtëse ka arritur moshën e pensionimit, dhe ai tani më është liruar nga funksioni i gjyqtarit.

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e tretë të vitit 2023 (1 korrik deri më 30 shtator 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Kaçanik.



Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	107	20	127	22	105
Penale shkalla e parë- DP	801	73	874	68	806
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë	1338	266	1604	80	1524
Jashtë kontestimore	302	9	311	31	280
Përmbarmore	1032	120	1152	23	1129
Përbarime sipas dokumenteve autentike	625	0	625	1	624
Përbarime sipas dokumentit përbarues	47	0	47	0	47
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	834	161	995	129	866
Ekz.civile PPP	133	27	160	23	137
Ekz.Penale me burg	33	4	37	6	31
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	174	37	211	37	174
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJT	5426	717	6143	420	5723
Lëndët tjera: çertifikata, v.apostile, etj	0	0	0	0	0

Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	908	223	1131	186	945
GJITHËSEJT	908	223	1131	186	945

Gjykata Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë

Të dhënat për lëndët e trashëguara, të pranuar, në punë, të kryera dhe lëndët e pa kryera për tremujorin e tretë të vitit 2023 (1 korrik deri më 30 shtator 2023) për Gjykatën Themelore në Ferizaj-Dega në Shtërpcë.

Lloji i lëndëve	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Procedura Paraprake - DP	45	1	46	1	45
Penale shkalla e parë- DP	163	17	180	32	148
Procedurë Paraprake - DKR	0	0	0	0	0
Penale shkalla e parë - DKR	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.përgaditore	0	0	0	0	0
Penale për të mitur në proc.Para Kolegjit	0	0	0	0	0
Civile të shkallës së I-rë	429	24	453	19	434
Jashtë kontestimore	30	4	34	6	28
Përmbarmore	231	35	266	7	259
Përbarime sipas dokumenteve autentike	0	0	0	0	0
Përbarime sipas dokumentit përbarues	17	0	17	0	17
Ekz.Paushalla dhe shpenzime gjyqësore	114	27	141	24	117
Ekz.civile PPP	20	0	20	1	19
Ekz.Penale me burg	2	1	3	0	3
Ekz. Penale me gjobë- EDGJ	9	12	21	5	16
Ekz.i masave edukative për të mitur	0	0	0	0	0
UGJK	0	0	0	0	0
GJITHËSEJTI	1060	121	1181	95	1086
Lëndët tjera: certifikata, v apostile, etj	0	0	0	0	0


Lëmia Kundërvajtëse	Lëndët të trashëguara	Lëndë të pranuar-2023	Gjithësejt lëndë në punë	Lëndë të kryera	Gjithësejt lëndë të pa kryera
Lëmia- Kundërvajtëse	137	22	159	33	126
GJITHËSEJTI	137	22	159	33	126

Nga gjyqtarët kërkohet që mos lejojnë shtyrje të panevojshme të seancave. Ngase kërkesat për shtyrjen apo për prova të reja nga palët ndonjëherë në thelb mund të mos kenë qëllimin legjitim, por mund të jenë të pajustificueshme dhe të kenë për qëllim vetëm prolongimin e proceseve. Në përgjithësi për të gjithë gjyqtarët është bërë me dije në secilin takim të kolegjiu me, që zbatimi i Planeve Strategjike të miratuara nga KGJK siç janë **Planit Strategjik për Përmirësimin e Qasjes në Drejtësi 2025 dhe Planit Strategjik për Zgjidhje Efikase të Lëndëve të Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar 2022-2024** dhe prioritetet që dalin nga këto strategji në trajtimin e lëndëve.

Në përfundim konsiderojmë se rritja e numrit të lëndëve sidomos të natyrës civile me theks të veçantë kërkesat e punëtorëve të arsimit, shëndetësisë, policisë etj që lidhen me kontratat kolektive, paraqesin sfidë për Gjykatën Themelore në Ferizaj, dhe për këto arsye në takime me gjyqtar të

divizionit civil është kërkuar që të angazhohen me tepër në trajtimin e lëndëve në këtë divizion duke u angazhuar edhe ndihma e bashkëpunëtorëve profesional, duke synuar që deri në fund të vitit të kemi një efikasitet më të lartë në raport të zgjidhjes së lëndëve.

Megjithatë qasja jonë është që edhe në këto kushte edhe kapacitete që kemi me gjyqtarët aktual por edhe stafi mbështetës administrativ, pavarësisht ngarkesës së rritur, duhet të bëjnë më shumë dhe të jenë më kërkuar në drejtim të shpejtësisë së gjykimit, rritjen e performancës dhe rrjedhimisht arritjes së rezultateve më të larta në punë, me qëllim që në vazhdimësi me kohë të trajtohen lëndët dhe kërkesat e ndryshme të qytetarëve- palëve, të cilët i drejtohen Gjykatës Themelore në Ferizaj.



Gjykata Themelore

Ferizaj

Sipas referencës:

GjA. nr. 314/23

Të datës: 20.10.2023

KËSHILLIT GJYQËSOR TË KOSOVËS

R A P O R T

për punët e kryera

Periudhat raportuese

Të vitit	Kohët e vitit	
2023	Çereku I.	
	Çereku II.	

	Çereku III.	2023
	Çereku IV.	
Tërësisht për vitin		

I. Nga menaxhimi i përgjithshëm:

1.

1. Juridiksioni i gjykatës	Është gjykatë themelore e rajonit të		Ferizaj		me Komunat rrethuese		
	Kjo gjykatë themelore			Sipas degëve të veta, të cilat			
	Funksionon në qytetin e:	Vendos sipas departamenteve:		Funksionojnë në:		Vendosin sipas departamentit nr.5:	
	Ferizajt	1. Krime të rënda		1	Kaçanik	5. I përgjithshëm sipas divizioneve:	Penal
		2. Për të mitur					2
		3. I përgjithshëm sipas divizioneve:		3			
4							
	Komenti:						

2.

2.1 Numri i gjyqtarëve sipas angazhimit në punë, paraqitur strukturën gjinore dhe përkatësinë nacionale:																					
Gjykata themelore + Degët e gjykatës										Aprovuara		0		Plotësuara		29		Lira		-29	
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej							
M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F				
18	7	0	3	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	19	10						
25		3		1		0		0		0		0		29							
Gjykata themelore				Ferizaj				Aprovuara		0		Plotësuara		20		Lira		-20			
Shqiptar		Serb		Boshnjak		Turq		Goran		Ashkalinj		Rom		Gjithësej							

2. Gjendja aktuale me aktivitate te burimeve njerezore

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës

1. Shfrytëzimi i pushimeve

Për të punësuarit në Gjykatë	Me pagesë				Pa pagesë		
	Vjetor	Mjekësor	Lehonie	Përdëllimit	Ngritje profesionale	Kujdes familjar	Tjetër
Gjyqtar	21	2	1	1			
Nëpunës	131	41		2			3
Total:	152	43	1	3	0	0	3

Komenti:

2. Procedurat e rekrutimit:

Për të punësuarit në Gjykatë	Te shpallura:			Lloji i kontrates		Rezultati i konkurseve	
	Konkurse te jashtme	Konkurse te brendshme	Nr. i kandidateve konkurrues	Karrieres / Jo karrieres	Punes	Pozitiv	Negativ
Gjyqtar							
Nëpunës	1						
Total:	1	0	0	0	0	0	0

Komenti:

3. Disiplinimi:

Për të punësuarit në Gjykatë	Disiplinimi	Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte		Lloji i masës	
	Numri i Disiplinimeve	Disiplinuar	Liruar	Disiplinuar	Liruar	Mase e lehte disiplinore	Mase e rende disiplinore
Gjyqtar							
Nëpunës							
Total:	0	0	0	0	0	0	0

Komenti:

4. Ankesat në përgjithësi:

Për të punësuarit në Gjykatë	Ankimimet			Komisioni i brendshem		Shkalla e dyte	
	Numri i ankesave	Ankese per rekrutim	Ankese tjeter	Miratuar	Refuzuar	Miratuar	Refuzuar
Gjyqtar	3				3		
Nëpunës							
Total:	3	0	0	0	3	0	0

Komenti:

Nëpunës								
Total:	0	0	0	0	0	0	0	0
Komenti:								

4.

Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës					
1. Për programin e buxhetuar të gjykatës për vitin 2023 shprehur në Euro valutë:					
Periodha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: I./2023	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	175,700.00 €	34,494.07 €	141,205.93 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	7,279.47 €	40,720.53 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		223,700.00 €	41,773.54 €	181,926.46 €
Komenti:					
Periodha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: II./2023	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	175,700.00 €	52,860.06 €	122,839.94 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	10,202.85 €	37,797.15 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		223,700.00 €	63,062.91 €	160,637.09 €
Komenti:					
Periodha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: III./2023	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	175,700.00 €	44,543.58 €	131,156.42 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €	12,397.95 €	35,602.05 €
	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €
	Në përgjithësi:		223,700.00 €	56,941.53 €	166,758.47 €
Komenti:					
Periodha:	Destinacioni i parasë:		Të buxhetuara:	Të shpenzuara:	Të pa shpenzuara:
Çereku: IV./2023	a.	Paga dhe mëditje	- €	- €	- €
	b.	Mallra dhe shërbime	175,700.00 €		175,700.00 €
	c.	Shpenzime komunale	48,000.00 €		48,000.00 €

4. Hyrje/daljet
financiare

	d.	Investime kapitale	- €	- €	- €	
		Në përgjithësi:	223,700.00 €	- €	- €	223,700.00 €
Komenti:						
Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës						
2.1. Të hyrat në buxhetin e Kosovës						
Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Taksë	Dënim	Paushall	Shpenzim	Konfiskim	
I./2023	95,057.61 €	209,494.00 €	- €	- €	- €	304,551.61 €
II./2023	69,007.58 €	178,160.00 €	- €	- €	- €	247,167.58 €
III./2023	71,610.49 €	150,833.00 €	- €	- €	- €	222,443.49 €
IV./2023	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Gjithësej:	235,675.68 €	538,487.00 €	- €	- €	- €	774,162.68 €
Komenti:						
Nga Gjykatat themelore + Degët e gjykatës						
2.2. Për të hyrat në Thesarin (Trezorin) e Kosovës						
Nga periudhat:	Të inkasuara në Euro valutë, sipas bazës paguese					Gjithësej
	Garancion për kontest	Depozitim (pignus) gjyqësor	Corpus delictie	Parapagim për shpenzime	Për raste tjera	
I./2023	- €	55,884.00 €	- €	- €	- €	55,884.00 €
II./2023	- €	24,419.80 €	- €	- €	- €	24,419.80 €
III./2023	- €	44,229.00 €	- €	- €	- €	44,229.00 €
IV./2023	- €	- €	- €	- €	- €	- €
Gjithësej:	- €	124,532.80 €	- €	- €	- €	124,532.80 €
Komenti:						

5.

--

5. Çështje Logjistike

Divizioni për logjistikë në GjTH-Ferizaj, më kapacitetet që disponon dhe me një menagjim të suksesshëm ka arrite të i përmbushë objektivat e përcaktuara në fillim të vitit. Në bashkpunim me Departamentin e Logjistikës në SKGJK-, kem fillu implementimin e projektit për riparimin komplet të sistemit të klimatizimit i cili deri më tani ka sjellë probleme të shumta në mirëmvajtjen e punëve në objekt, jami në fillim apo përfundim të shumë projekteve të cilat është i kyqur drejtëpërdrejtë Divizioni për Logjistikë i kësaj gjykate.- Po theksojmë se për muajin. VII-VIII-IX/2023, automjetet e Gjykatës Themelore në Ferizaj me degë gjatë kësaj periudhe kanë kaluar . 30437.Km, dhe kanë hargjuar 1970.Litra karburante ose shprehur në hargjime në 100 km ,5.93 litra .- Është bërë përpjekje maksimale për kujdesin e mirë mbajtjes së objektit me theks të veqant në mbajtjen e higjienës. - Divizioni për logjistikë gjatë punës nuk ka pasë probleme dhe ngecje, është përkujdesë që furnizimi me material të jetë në nivel dhe mos të ketë pengesa gjat procesit të punës.

6.

6. Prokurimi Publik	Numri i prokurimit publik	Lloji i kërkesës	Shuma	Realizimi	
				po	jo
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
			- €	0	0
KGJK					

7.

7. Projektet e realizuara	1. Numri i projektit	
	2. Emërtimi i projektit:	
	3. Partenerët e projektit:	
	4. Vlera e projektit:	
	5. Të involvuarit në projekt:	
	6. Kostoja e projektit:	
	7. Rezultatet e projektit:	
	Komenti:	

8.

8. Identifikimi i pengesave në punët për vendimarrje lidhur me paqartësi ligjore në zbatim

Edhe në tre mujorin e III-të, si pengesë kryesore e funksionimit të punës paraqitet sistemi Smil, i cili paraqet vështirësi si për përdoruesit e adimistratës ashtu edhe për gjyqtarët pasi që paraqiten herë pas here probleme të sistemit të cilat ngadalsojnë punën e Gjykatës deri në rregullimin e tij ka ndodhur me ditë radhaz, e që siç dihet në Gjykatën Themelore në Ferizaj, gjitha veprimet me lëndën mirren vetëm përmes sistemit smil pasi që edhe librat Gjykatës tani më nuk janë në përdorim. Në çdo mbledhje të kolegjiut gjyqtarët i paraqesin vështirësit e tyre sa i perket sistemit, si dhe me planin e rishpërndarjes së lëndëve jo te gjitha ndryshimet e gjyqtareve sistemi i ruan edhe pse kryhet veprimi i ricaktimit dhe në kohë të fundit vërehet se lënda nuk është në emer të tij, dhe kjo merr kohë për gjyqtarin që lënda të bartet në emer të tij. ndërsa si problem po ashtu janë identifikuar si nga gjyqtarët po ashtu edhe zyra e statistikave mos barazimi i lëndëve fizike dhe atyre në sistem.

ç

9.

9. Mbledhjet e mbajtura lidhur me menaxhimin e gjykatës dhe lëndëve gjyqësore

Me qëllim të menagjimit dhe efikasitetit në punë të Gjykatës Themelore në Ferizaj dhe Degët e saja Kaçanik dhe Shterpcë, Kryetari i Gjykatës ka mbajtur takime të rregullta me mbikqyrësit e Degëve si dhe gjyqtarët e kësaj Gjykate dhe atë takimi i datës 16.08.2023, me gjyqtarët e Departamentit për Krime të rënda, Departamenti i përgjithshëm penal si dhe për të Mitur, Takimi i datës 01.09.2023 me gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm Divizioni Civil, Takimi i datës 18.09.2023 i mbajtur me mbikqyrësit e Degëve si dhe gjyqtarët e Departamentit të Përgjithshëm-Divizioni Civil. Janë mbajtur edhe takime të tjera ai datës 17.07.2023 nga Udhëheqësi i Divizionit Civil takimi i mbajtur me datë 08.08.2023, me gjyqtarët e Departamentit të për të Mitur dhe Divizionit Penal me ftesë nga Nënkryetarja Mirlinda Bytyqi-Rexhepi, Me ftesë të Kryetarit të Gjykatës takimi i datës 14.08.2023 me referentët e zyrës për menagjimin e lëndëve, mbikqyrësit e sektorit pranim regjistrim dhe menaxhim, Mbikqyrësin për ekzekutim arkivim dhe statistika. Takimi i datës 16.08.2023 me ftesë të Kryetarit me referentët pranim regjistrim, Mbikqyrësit e sektorit ekzekutim arkivim dhe statistika si dhe udhëheqësi i zyrës për shërbime të përbashkëta. Takimi i datës 17.08.2023 me ftesë të Admisistratorit të Gjykatës me bashkëpunetorët profesional zyrtarët ligjor dhe sekretaret juridike. Takimi i datës 05.09.2023 me ftesë të Kryetarit me bashkëpunetorët profesional.

10.

10.

Identifikimi i pengesave në punë dhe propozimi i masave për tejkalimin e tyre

Edhe në këtë tre mujor të III-të, paraqes gjendjen e arkivës së Gjykatës sonë, e cila si problem na ka përcjellur në vazhdimësi si me mungesën e hapsirës, po ashtu edhe me kushtet e vetë hapsirave të arhivave. Në mungesë të këtyre hapsirave si arhive janë adaptuar edhe hapsira që nuk janë të dedikuara për arhive dhe nuk plotësojnë kushtet për një arhivë, sepse nuk ka sistem të ajrosjes e as mundësi për të adaptuar një sistem të till nga gjykata. Për shkak të këtyre kushteve zyrtari i arhivës ka pasur edhe probleme shëndetsore. Po ashtu këto hapsira të arhivave janë në podrumin e gjykatës, i cili siç edhe ju kemi njoftuar disa herë vazhdimisht pas të reshurave kemi vërshim uji në hapsirë ku edhe janë rrezikuar edhe vetë arhivat. Andaj këto probleme me arhivat e gjykatës, dhe me sistemin e kanalizimit i cili pas çdo të reshure me shi ka kthim të ujit dhe vërshim të bodrumit kërkojnë ndërhyrje urgjente në sanimin dhe rregullimin e tyre. Problemi tjetër është me arhivën e lëndëve të noterëve të pensionuar të cilat janë në këtë gjykatë, edhe kjo pjesë e hapsirës së kësaj arhive është në gjendje shumë të rëndë, pasi që në mungesë të sistemit të ajrosjes ka filluar edhe dëmtimi i vetë lëndëve të cilat janë në këtë arhive, për të cilat vazhdimisht kemi paraqitur si shqetësim në KGJK, për këtë arsye kërkojmë ndërhyrje urgjente nga departamenti i ligjistikës pranë SKGJK.

11.

11.

Bashkëpunimi i gjykatës me subjektët jo gjyqësor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Gjykata Themelore në Ferizaj edhe në këtë tre mujor të III-të, ka vazhduar bashkëpunimin me përfaqësues të Institucioneve tjera, duke dhënë kontributin e saj në këto takime. Takime të rregullta me Prokurorinë Themelore në Ferizaj, Policinë e Kosovës Qendra për Punë Sociale si dhe USAID. Në Gjykatën Themelore në Ferizaj, vazhdon implementimin e projektit, Planit të veprimit të projektit për drejtësi Procedurale. Investim nga Ambasada Amerikane është edhe projekti i audio-ingjizimit në sallat e gjykimve, të cilat paisje veç se kanë filluar të montohen në sallat e gjykimeve në Gjykatën Themelore në Ferizaj, nga kompania e kontraktuar në bashkëpunim me IT-të e Gjykatave si dhe operatorët.

12.

12. E
rëndësisë së
veçantë për
paraqitje në
KGJK

II. Treguesit statistikor për lëndët gjyqësore:

III. Përmbyllja

1

Rekomandime
për KGJK

Si rekomandim dhe më urgjente për Këshillin Gjyqësorë Të Kosovës konsiderojmë, çështjen e sistemit Smil, rregullimet dhe intervendimet nga zyrtaret e ketij sistemi problemet dhe ndalesat të minimizohen.

2

Përfundim
përmbledhës

Periudha e tremujorit të III-rë 2023, ka qenë periudhë e suksesshme në aspektin e ngritjes së efikasitetit të përfundimit të lëndëve. Çështje penale të arritura gjatë kësaj periudhe përfshirë degët kanë qenë 302 , ndërsa janë përfunduar 305 lëndë apo shprehur në përqindje norms e efikasitetit është mbi 100.99%. Lëndë penale në Departamentin për Krime të Renda, janë pranuar 24, ndërsa janë përfunduar 29, norma e spastrimit është 120.83%. Te rastet civile gjatë kësaj periudhe (së bashku me degë) janë pranuar 1029 lënd, ndërsa janë përfunduar 493 lëndë , norma e spastrimit është 47.91%. Ndërsa lënd në Divizionin për Kundërvajtje janë pranuar 863, ndërsa janë përfunduar 720 apo mbi 83.43%.

Kryetari i gjykatës

MUSTAFA TAHIRI

(nënshkrimi)

